Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-788 Datë: 30.07.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 30.07.2026 merr:

V E N D I M

1. **REFUZOHET** ankesa ndaj Vendimit nr. 01-469, datë 29.05.2026, për riakreditim dhe rivalidim, e paraqitur nga Institucioni për Aftësim Profesional "Elektrowati", me lokacione në Prishtinë dhe Pejë, me adresë në Rrugën UÇK nr. 62, Pejë, dhe nëndegë në Rrugën Luan Haradinaj, Pallati i Rinisë, Prishtinë, Republika e Kosovës, për kualifikimin: ***"Instalues Elektrik"*** **Niveli III i KKK,** lloji: Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D) me pesëmbëdhjetë (15) kredi të IAAP.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Me datë: 05.06.2026 Institucioni per Aftesim Profesional "Elektrowati", ka parashtruar ankese në AKK Nr.prot. 507-01 për riakreditim dhe rivalidim të institucionit për kualifikimin **Instalues *"Instalues Elektrik"* Niveli III i KKK,** lloji: Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D) me pesëmbëdhjetë (15) kredi të IAAP. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushë veprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për riakreditim dhe rivalidim për kualifikimin si më lartë.

Ekipi i ekspertëve, pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit për akreditimin e kualifikimit, ka realizuar vizitën vlerësuese në Institucionin për Aftësim Profesional "Elektrowati"përkatësisht në degën e Pejës. Gjatë procesit të vlerësimit janë shqyrtuar kushtet materiale, infrastrukturore dhe organizative të institucionit, si dhe kapacitetet e tij për realizimin e procesit të aftësimit profesional, përfshirë zhvillimin e pjesës teorike dhe praktike të programit.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, raportet e ekspertëve janë dorëzuar më datë 29.06.2026. Bazuar në shqyrtimin dhe analizimin e dosjes së aplikimit, gjetjet e evidentuara gjatë vizitës në institucion, si dhe përfundimet dhe rekomandimet e paraqitura në raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve, çështja është proceduar për shqyrtim dhe vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues, të mbajtur më datë 30.07.2026.

Në kuadër të vlerësimit të kapacitetit të institucionit për numrin e kandidatëve për grup, është marrë në konsideratë edhe historiku i akreditimit për të njëjtin lokacion. Në ciklin paraprak të akreditimit, institucioni ka qenë i akredituar dhe i validuar për 10 kandidatë për grup. Duke qenë se gjatë procesit aktual të vlerësimit nuk janë evidentuar ndryshime thelbësore në kushtet materiale, infrastrukturore dhe organizative të institucionit, ekipi i ekspertëve ka vlerësuar se nuk ekziston bazë profesionale dhe faktike për ndryshimin e këtij rekomandimi.

Në këtë kontekst, përcaktimi i numrit të kandidatëve për grup nuk mund të bazohet vetëm në sipërfaqen fizike të objektit, por duhet të marrë në konsideratë një tërësi faktorësh, përfshirë standardet e sigurisë, kushtet dhe pajisjet në dispozicion, cilësinë e procesit mësimor, mundësinë e realizimit të pjesës praktike, si dhe kapacitetin e institucionit për të garantuar realizimin efektiv të rezultateve të të nxënit.

Nga gjetjet e evidentuara gjatë vizitës së ekspertëve nuk është identifikuar ndonjë element i ri ose ndonjë ndryshim në kapacitetet ekzistuese që do të arsyetonte rritjen e numrit të kandidatëve nga 10 në 15 kandidatë për grup. Përkundrazi, kushtet e konstatuara gjatë vlerësimit janë në përputhje me ato të evidentuara në ciklin paraprak të akreditimit, në të cilin kapaciteti ishte përcaktuar në 10 kandidatë për grup.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

- *Institucioni Profesional "Elektrowati"*
- *Arkivit të AKK.*

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve